



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR.04/2025 PËR NDRYSHIMIN
DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2023
PËR AMBALAZHIN DHE MBETURINAT E AMBALAZHIT¹**

¹ Udhëzim administrativ (QRK) Nr.04/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 07/2023 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit, i miratuar në Mbledhjen e 255-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 03/255, të datës 28.03.2025.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina (Gazeta Zyrtare Nr.29 e datës 1 shtator 2022), nenit 8 paragrafi 4, nën paragrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.34/22 e datës 18 nëntor 2022),

Nxjerr;

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 04/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2023 PËR AMBALAZHIN DHE MBETURINAT E AMBALAZHIT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.07/2023 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit.

Neni 2

1.Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.16. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.16. **Prodhues** - personi fizik ose juridik, i cili prodhon ose importon dhe nxjerr në treg për qëllim të aktivitetit të tij tregtar produkte të vendosura në ambalazh.

Sa i përket SRD-së, prodhues konsiderohet prodhuesi vendor i pijeve të ambalazuara që është objekt i SRD-së, si dhe prodhuesi konsiderohet ose pronar i markës/brendit për produktet e markës në Kosovë, ose importues për produktet e markuara jashtë Kosovës;

2.Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.17.**Prodhues i vogël** – personi fizik ose juridik, i cili prodhon ose importon dhe nxjerr në treg për qëllim të aktivitetit të tij tregtar produkte të vendosura në ambalazh, nën sasinë pesëmbëdhjet mijë litra (15000) litra brenda vitit;

3.Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.29. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.29. **Tarifa e trajtimit** - Tarifa e paguar për shitësit me pakicë nga Administratori i SRD-së, nëpërmjet transfertës bankare, për çdo shishe/ambalazh të SRD- së, i kthyer në pikën përkatëse të kthimit. Tarifat e trajtimit të synuara për mbulimin e kostos direkte lidhur me përmbushjen e detyrimeve të grumbullimit dhe trajtimit të ambalazhit të pijeve të SRD- së.

4. Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.33. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.33. **Tarifa e Prodhuesit** - Tarifa e arsyeshme që paguhet nga prodhuesi, përmes transferit bankar, te administratori për çdo ambalazh të pijeve që bie nën fushën e SRD-së dhe që hidhet në treg, e cila ka për qëllim mbulimin e kostove të krijuara nga zbatimi dhe funksionimi i SRD-së.

5. Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.34. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.34. **Shitësit me pakicë** - përfshijnë hipermarketet, supermarketet, dyqane të vogla, lokale dhe të tjera si kioska, stacionet e karburantit që shesin ambalazh pije për konsumatorët dhe pranojnë ambalazhin e shpaguar për të cilin paguhet depozita, gjithashtu shitës me pakicë HORECA nënkuptohen edhe operatorët ekonomik në industrinë e hotelerisë, shërbimeve ushqimore, veçanërisht objektet që organizojnë evente, përgatitin dhe shërbejnë pije të SRD.

6. Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.35. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.35. **Makina Shitëse Kthyesë** - një pajisje e automatizuar që pranon ambalazhë të zbrazët të pijeve, vërteton kthimin e ambalazhës të SRD- së për një herë të vetme duke verifikuar pranueshmërinë e ambalazhës të SRD- së dhe lëshon një tiketë për rimbursim të shumës së depozites të shkruar në ambalazhë, që është paguar më parë;

7. Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.37. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.37. **Operator i pikës së kthimit** - shitës me pakicë/person juridik që ofron shërbimin për të mbledh shishe/ambalazhet e pijeve të riciklueshme të përfshira në SRD-së dhe rimbursion depozitat e konsumatorëve;

8. Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.38. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.38. **Depozita të Pashlyera** – vlera e depozitave të paguara për shishe/ambalazhet e pijeve te Administratori i SRD-së, të hedhura si mbeturina të cilat nuk janë rimbursuar te shitësit me pakicë për vitin fiskal të kaluar.

9. Neni 3, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.38. i Udhëzimit Administrativ bazë shtohet një nënparagraf i ri me tekstin si në vijim:

1.39.**Tiketë/kupon** - biletë fizike, e lëshuar nga paisja automatike që pranon ambalazhin e konsumatorit ose përdoruesit të fundit, e cila mund të përdoret ose për të paguar për blerje.

Neni 3

1. Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.2. Ndalohet prodhimi, importi dhe shitja në treg e qeseve plastike mbajtëse dhe thasëve të okso-degradueshme;

Neni 4

1. Neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.1.Të mbajnë shënime të veçanta kontabël për çmimin e pijeve, tarifën e prodhuesit dhe shumën e depozitës.

Neni 5

1. Neni 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i nën-nënparagrafit 1.1.2 i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.1.2. Është projektuar që të përmbajë të paktën zeropikëpesëmdhjetë (0,15) litra lëng dhe jo më shumë se dy (2) litra lëng, dhe të jetë i mbyllur në gjendje hermetike dhe të papërshkueshme nga uji në pikën e shitjes.

Neni 6

1.Neni 20, paragrafin 4, nënparagrafi 4.3. i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

4.3. Ambalazhin me kapacitet më të madh se dy (2.0) litra dhe ambalazh me kapacitet më të vogël se zero pikë pesëmdhjetë (0.15) litra.

Neni 7

1.Neni 21,paragrafi 2, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

2. Objektivat e normës së kthimit të SRD-së fillojnë të zbatohen nga dita e funksionimit të sistemit të kthimit të ambalazhit prej makinave shitëse kthyesë në praktik, respektivisht tetëmbëdhjetë (18) muaj pas Vendimit përfundimtar të miratimit të administratorit.

Neni 8

1.Neni 22, paragrafi 2, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

2.Administratori përbëhet nga konsorcium i personave juridikë që përbëjnë të paktën nga një (1) strukturë të asociuar të prodhuesëve, një (1) strukturë të asociuar importuesëve dhe një (1) strukturë të asociuar të shitësve me pakicë të cilët plasojnë në treg dhe shesin pije në shishe/ambalazh që janë subjekt i SRD-së, të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Neni 9

1.Neni 23, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

3.1.Plani biznesor që përfshin gjithashtu planin organizativ për SRD, së bashku me përshkrimin teknikë për funksionimin e tij, ku sistemi i kthimit të ambalazhit që janë subjekt i SRD-së do të bëhet përmes sistemit automatik me makina shitëse kthyesë;

2. Neni 23, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

3.3.Marrëveshja e konsorciumit sipas paragrafit 2 të Nenit 22, të Udhëzimit Administrativ bazë, përbëhet nga një asociacion të secilës kategori të prodhuesëve, importuesëve dhe shitësve me pakicë të pijeve të ambalazuara që janë subjekt i SRD-së, të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Neni 10

1.Neni 27, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.1. Krijojë, administrojë dhe financojë SRD-në, në përputhje me dokumentet bazë të Administratorit si dhe të aplikoj kthimin e ambalazhit që janë subjekt i SRD përmes sistemit automatik me makina shitëse kthyesë.

2.Neni 27, pas paragrafit 1, i Udhëzimit Administrativ bazë, shtohet paragraf i ri, me tekstin si në vijim:

2.Administratori i SRD-së, gjithashtu ka detyrimet e mëposhtme:

2.1. Të sigurojë që të gjitha sasi të ambalazheve të SRD-së të kthyera të dërgohen për riciklim dhe të ofrojë gjurmë të ambalazheve të SRD-së nga pikat e kthimit deri në qendrën e numërimit, përkatësisht të ricikluesi, përmes dokumenteve financiare-kontabël dhe dokumenteve tjera mbështetëse.

2.2. Të sigurojë dhe të paguajë për mbledhjen e ambalazheve të SRD-së nga pikat e kthimit me një frekuencë dhe në një mënyrë që nuk pengon funksionimin e duhur të shitësve me pakicë, sipas kontratës, por jo më rrallë se një herë në pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.

2.3. Të ruajë në kushte të sigurta të dhënat konfidenciale të raportuara nga operatorët ekonomik sipas Udhëzimi Administrativ bazik dhe këtij Udhëzimi Administrativ, nëse të dhënat e tilla i komunikohen atij. Ky detyrim aplikohet edhe për anëtarët e organeve përbërëse dhe për stafin e punësuar nga administratori i SRD-së. Të dhënat që administratori i SRD-së është i detyruar t'i raportojë Ministrisë ose autoriteteve të tjera kompetente, si dhe ato që duhet t'i bëhen të njohura publikut sipas Udhëzimi Administrativ bazik dhe këtij Udhëzimi Administrativ, do të transmetohen në përputhje me detyrimin e konfidencialitetit ndaj operatorëve ekonomik brenda sistemit.

2.4. Të publikojë të dhëna në faqen e tij të internetit, në përputhje me detyrimin e konfidencialitetit ndaj operatorëve ekonomik brenda sistemit sasinë e ambalazheve të SRD-së të futura në treg dhe, përkatësisht, të kthyera, në kilogramë dhe në numër copash, për secilin lloj materiali: plastikë, alumin, qelq, deri më datë 15 të muajit pasues për muajin e mëparshëm si dhe Informacione të destinuara për konsumatorët lidhur me funksionimin e sistemit të depozitës dhe kthimit dhe mundësinë e tyre për të kthyer ambalazhet e SRD-së për të rikuperuar depozitën.

Neni 11

1.Neni 28, paragrafi 6, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

6. Nëse importuesi ose prodhuesi refuzon të regjistrohet në sistemin e rimbursimit të depozitës, zbatohet taksa prej zero pikë njëzeteshtatë (0.27) euro për litër të ambalazhit të pijës për atë importues ose prodhues nga data e hyrjes në fuqi të SRD.

Neni 12

1.Neni 30, paragrafi 5, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

5. Një depozitë e paguar kthehet kur konsumatori dorëzon ambalazh në sasi të arsyeshme në gjendje të kthyeshme në të cilën është vendosur depozita në vendin e shitjes së pijeve ose në një vend të përcaktuar për këtë qëllim në çdo pikë kthimi në Kosovë, pavarësisht nga vendi nga i

cili është blerë produkti i ambalazhuar dhe pa u kushtëzuar nga fatura e blerjes për të rimbursuar depozitën, sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ bazë dhe këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 13

1.Neni 47, paragrafi 2, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

2. SRD hynë në fuqi tetëmbëdhjetë 18 muaj pas vendimit përfundimtar të miratimit të administratorit.

2. Në nenin 47, pas paragrafit 3, te Udhëzimit Administrativ bazë shtohet paragraf i ri me tekstin si në vijim:

4. Periudha kalimtare për shitjen e stokeve të pijeve të ambalazuara është gjashtë (6) muaj pas fillimit të zbatimit të sistemit të SRD për kthimin e ambalazheve që mund të shiten.

Me rastin e fillimit të zbatimit të sistemit të rimbursimit të depozitës të SRD -së të gjithë prodhuesit, importuesit dhe shitësit me pakicë nuk mund të prodhojnë, importojn apo shesin pije të ambalazuara që janë subjekt i SRD pa plotësimin e kërkesave, respektivisht dispozitave për ambalazh dhe mbeturinat e ambalazhit si dhe SRD- së, përveç për produktet që janë në stokun e prodhuesve, importuesve ose shitësve me pakicë në datën e përcaktuar në nenin 47 paragrafin 2. të përshkruar në këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 14

Caktimi i ndërmarrjes publike qendrore si Administrator në rast të dështimit të procesit të përzgjedhjes nga sektori privat

1.Nëse procesi për themelimin e Administratorit dështon për shkak të mos përmbushjes së dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ bazë dhe këtij Udhëzimi Administrativ, Komisioni, do të dorëzojë raport pranë Ministrit.

2.Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë, merr vendim për caktimin e një ndërmarrjeje publike qendrore si Administrator për SRD.

3.Pas marrjes së këtij vendimi nga Qeveria, dispozitat e mëposhtme të Udhëzimit Administrativ bazë nuk janë më të aplikueshme:

3.1. Neni 22, paragrafi 1 dhe 2;

3.2. Neni 23, paragrafi 1, 2, 3-nënparagrafi 3.3.;

3.3. Neni 24, paragrafi 1,

3.4. Neni 25;

3.5. Neni 26;

3.6. Neni 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3.

4.Neni 23, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ bazë, në rastin e caktimit të Administratorit nga sektori publik, pas vendimit të Qeverisë, Administratori dorëzon në Ministri të gjitha dokumentet brenda afatit sipas paragrafit 3 të nenit 23 të Udhëzimit Administrativ bazë.

5.Pas caktimit të Administratorit nga sektori publik, emërohet komisioni i përbërë nga pesë (5) anëtarë nga Ministri.

6.Ndërmarrja publike qëndrore që merr detyrat e Administratorit do të ushtrojë të gjitha funksionet dhe kompetencat e Administratorit të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ bazë dhe këtë Udhëzim Administrativ, duke vepruar në përputhje me parimet e eficiencës, transparencës dhe trajtimit të barabartë të të gjithë subjekteve të përfshira në SRD.

7.Të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas të gjitha neneve që rregullojnë punën, obligimet dhe detyrimet e Administratorit mbeten të vlefshme, me përjashtim të afateve kohore për përmbushjen e tyre, të cilat mund të rishikohen në bazë të një kërkesë të arsyetuar nga Administratori, e cila duhet të dërgohet me shkrim te Komisioni i caktuar nga Ministri.

8.Komisioni shqyrton kërkesën, vlerëson arsyet e parashtruara dhe brenda një afati prej shtatë (7) ditëve pune i përgjigjet Administratorit për miratimin ose refuzimin e zgjatjes së afatit, duke përcaktuar një afat të ri vetëm nëse vlerësohet se shtyrja është objektivist e justifikueshme dhe nuk cënon zbatimin e përgjithshëm të SRD-së.

9.Përjashtim nga kjo përbën afati për fillimin e funksionimit të SRD-së i cili duhet të fillojë jo më vonë se tetëmbëdhjetë (18) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit për caktimin e ndërmarrjes publike si Administrator.

10.Në rast të vonesave të justifikuara që ndikojnë në afatin e fillimit të SRD-së, Qeveria, me propozimin e Ministrisë, mund të vendosë një shtyrje të afatit për një periudhë të arsyeshme, por vetëm mbi bazën e një vlerësimi objektiv të arsyeve të vonesës dhe pa cenuar objektivin për zbatimin e plotë të SRD-së në një periudhë sa më të afërt kohore.

11.Për të siguruar funksionalizimin e SRD-së në përputhje me detyrimet ligjore dhe praktikat më të mira, Administratori do të bashkëpunojë ngushtë me komisionin e emëruar nga Ministri i cili për funksionimin e SRD-së, përfshirë por pa u kufizuar në:

11.1.Organizimin dhe operimin e sistemit të informacionit për SRD-në;

11.2.Hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe promovuese për SRD-në.

12.Ministria është përgjegjëse për monitorimin e progresit të zbatimit të SRD-së nga Administratori dhe Administratori duhet të paraqesë raporte periodike pranë Ministrisë për përmbushjen e afateve dhe përparimin në funksionalizimin e sistemit.

13.Nëse Administratori publik dështon të përmbushë detyrimet e tij brenda afateve të përcaktuara, Qeveria, me propozimin e Ministrisë, mund të shqyrtojë opsionet për ndryshimin e modelit të administrimit të SRD-së ose për caktimin e një subjekti tjetër për menaxhimin e tij, duke marrë në konsideratë interesin publik dhe sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemit.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Datë: 09.prill. 2025